



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2023:136273
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05839433

PPP.nr.8/24

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtaren Adelina Jusufi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “A. M.” Sh.p.k., me numër unik identifikues (NUI), me seli në adresën Ç... – V..., P... kundër debitorit M. Z. nga fshati S..., K... e P..., lidhur me pagimin e borxhit në vlerën prej 9,000.00 €, duke vendosur lidhur me prapësimin, jashtë seancës, me datë 20.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi, i parashtruar nga debitori . Z. nga fshati S..., K... e P..., i ushtruar ndaj urdhrit të përmbaruesit privat Destan Bujupi me seli në Prishtinë, P.nr.264/23 të datës 30.05.2023, mbi lejimin e përmbarimit.

II. Urdhri përmbarimor P.nr.264/23 të datës 30.05.2023, i lejuar nga përmbaruesi privat Destan Bujupi me seli në Prishtinë, **MBETET NË FUQI**.

III. Në rast se debitori parashtron ankesë kundër këtij aktvendimi, **OBLIGOHET** që në afat prej 7 (shtatë) ditësh ta paguaj garancionin në xhirollogarinë e kësaj gjykate në shumën prej 900.00 € (Euro).

IV. Në rast se debitori dështon të paguaj shumën e lartcekur të garancionit brenda afatit të caktuar, ankesa e ushtruar kundër këtij aktvendimi do të konsiderohet se nuk është dorëzuar fare.

A r s y e t i m

Kreditori “A. M.” Sh.p.k., me numër unik identifikues (NUI) ..., me seli në adresën Ç... – V..., P..., në bazë të dokumentit të besueshëm Fatura nr.4/2023 e datës 06.05.2023, ka parashtruar propozim për përmbaerim pranë Përmbaeruesit Privat Destan Bujupi me seli në Prishtinë, P.nr.264/2023 të datës 30.05.2023, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet debitori . Z. nga fshati S..., K... e P..., që të ja paguaj detyrimin prej 9,000.00 €, me kamatë ligjore prej 8% sipas LMD-së dhe shpenzimet e procedurës përmbaerimore, nën kërcënim të përmbaerimit të dhunshëm dhe pasojave të tjera ligjore.

Përmbaeruesi privat Destan Bujupi, më Urdhrin P.nr.264/23 të datës 30.05.2023 e ka lejuar përmbaerimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori, brenda afatit ligjor ka parashtruar prapësim kundër urdhrin për lejimin e përmbaerimit të përmbaeruesit privat, ku ka kundërshtuar se ekziston kontrata e shitblerjes së automjetit ku sqarohet se është kryer pagesa, po ashtu kundërshton faturat e prezantuar nga ana e kreditorit, me propozimin që ta aprovoj prapësimin dhe të shfuqizohet urdhri përmbaerimor dhe të ndërpriten të gjitha veprimet procedurale në procedurë përmbaerimore.

Kreditori ka parashtruar përgjigje në prapësim duke pretenduar se prapësimi i debitorit është bërë vetëm me qëllim të shtyrjes dhe prolongimit i pagesës së borxhit, se pretendimi i debitorit në prapësim janë bërë vetëm për ta vënë gjykatën në lajthim me gjendjen reale, se nuk ka ofruar as një dëshmi me të cilin ish dëshmuar se nuk ka borxh, se fatura është pranuar nga debitori dhe kjo faturë është paraqitur në ATK si faturë e rregullt, dhe i ka propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar dhe urdhër të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se, prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe se urdhri përmbaerimor duhet të mbetet në fuqi, dhe atë për shkak se si në vijim: Gjykata vlerëson se, organi përmbaerues ka lejuar përmbaerimin bazuar në nenin 21 të LPP-së, i cili përcakton se: “Organi përmbaerues e cakton,

përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”.

Në rastin konkret propozim është iniciuar në bazë të dokumentit të besueshëm- Fatura nr.4/2023 e datës 06.05.2023, Gjykata vlerëson se e njëjta i përmban të dhënat për kreditorin dhe debitorin, si dhe është përcaktuar objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar. Për më tepër, fatura në fjalë rezulton të jenë pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e palës debitore, fakt ky i cili vërtetohet në bazë të nënshkrimit të debitorit.

Gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës duke vendosur dhe atë duke u bazuar në Nenin 21 dhe 29 të LPP-së, kjo pasi që fatura është dokument i besueshëm, dhe në bazë të Nenit 29 par. 1 LPP-së që përcakton se “Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm. Dokument i besueshëm, sipas këtij ligji është: 1.1. kambialet dhe çeqet me potest dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës; 1.2. ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave; 1.3. faturat; 1.4. dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike; 2. Llogaritja e kamatës konsiderohet si pjesë e dokumentit të besueshëm”.

Po ashtu, gjykata konsideron se prapësimi i debitorit është i pabazuar ngase bie në kundërshtim të plotë me dokumentin e besueshëm, përkatësisht Fatura nr.4/2023 e datës 06.05.2023, e në bazë të së cilit detyrohet tani debitori, që t’ia paguajnë tani kreditorit shumën prej 9,000.00 €, ku debitori nuk ka ofruar ndonjë dëshmi me të cilën vërtetohet se i njëjti e ka kryer pagesën, prandaj, në rastin konkret dokumenti përbarimor në bazë të së cilit është lejuar përbarimi është i përshtatshëm dhe i përbarueshëm dhe i përcaktuar qartë detyrimi i debitorit ndaj kreditorit.

Gjykata në mungesë të argumenteve nga ana e debitorit, duke mos i provuar deklaratimet si në prapësimin e ushtruar, vendosi si në dispozitiv të të njëjtit, konform nenit 69 paragrafi 4 të LPP-së “baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura”. Gjykata ka vlerësuar edhe theksimet e tjera të debitorit në prapësim, por ka gjetur se të njëjtat janë pa ndikim në nxjerrjen e ndonjë vendimi tjetër.

Gjykata, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore, duke iu referuar dispozitave ligjore të nenit 73 paragrafi 1 të LPP-së i cili përcakton se “Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore”, përjashtimisht Gjykata mund të caktoj seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit.

Në pikën III të dispozitivit të këtij aktvendimi, gjykata e obligoi debitorin që në rast të parashtrimit të ankesës kundër këtij aktvendimi, në afat prej 7 ditësh ta paguajë garancionin në mjetet buxhetore të gjykatës në shumën prej 900.00 €, duke u mbështetur në dispozitën nga neni 78 par.2 të LPP-së, ndërsa në pikën IV të dispozitivit e paralajmëroi debitorin se në rast të dështimit të pagesës së shumës së përcaktuar nga Gjykata brenda afatit të paraparë, ankesa do të konsiderohet se nuk është paraqitur fare, në kuptim të nenit 78 par.4 të LPP-së.

Andaj nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 73 të LPP-së, dhe në bazë të argumentimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil
PPP.nr.8/24 të dt.20.06.2024

Gjyqtarja,
Adelina Jusufi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjti, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.